



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

Lënda : Kthim Përgjigje.

Pranë bashkisë Shkodër është administruar me nr. 18472 prot datë 16.09.2024 kërkesa për informacion ku është kërkuar :” *Sa fonde keni marr/shpërndarë për minoritetin Rom & Egjiptjan? Kush janë investimet që janë kryer gjatë 3 viteve të fundit nga Bashkia juaj për Romët & Egjiptjanët? Nëse janë kryer, sa kanë kushtuar? Nëse ka pasur tender për këto investime, kush ka qënë fituesi i këtyre tenderave? Nga kanë ardhur fondet për këto investime? A kanë marrë fëmijet e minoritetit Rom & Egjiptjan bursa nga bashkia juaj? Sa fëmijë kanë përfituar, dhe në çfarë zone dhe nga cila shkolla janë ato fëmijë?”*

Sa më sipër ju kërkoni bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit” ju bëjmë me dijeni se : Bashkia Shkodër gjatë tre viteve të fundit ka bërë disa investime në të gjithë territorin e sajë, përfitues të cilëve janë komunitete të ndryshme të cilët banojnë në këto zona dhe që nuk diferencohen nga njëri tjetri.

Përsa i përket bursave, Bashkia Shkodër po implementon projektin “Punësim dhe mësim për përfshirjen sociale” në bashkëpunim me fondacionin OSFA dhe me financimin e Bashkimit Evropian me fokus komunitetin rom dhe egjiptian. Projekti synon gjithëpërfshirjen e komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri në fushën e punësimit dhe arsimit. Një ndër aktivitetet kryesore të projektit janë: Bursat Nga ky program përfitojnë 30 nxënës të komunitetit, të cilët i përkasin shkollave 9 vjeçare: Liria, Ali Lacej, Pashko Vasa dhe Isuf Tabaku. Nxënësit përfitues marrin bursa mujore për një periudhë 10 mujore. Gjithashtu për të lehtësuar shpenzimet e familjeve romë dhe egjiptiane është parashikuar që nxënësit të ndihmohen me materiale shkollore si: çanta, libra dhe aksesore shkollore, të cilat po shpërndahen me fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025.

**KRYETAR**

**Benet BECI**